



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 13008
U. Br.
Data: 28/05/2025
Datum: 28/05/2025
KAMENICË/A



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.204, datë:27.05.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.12563 e datës 23.05.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Servisimi i projektorit kryesor të kinemasë"**, me numër të kontratës **KM653-25-3660-2-3-6**, si në vijim:
 - 1.1. **z. Lulzim Rexhepi (DKRS)**, CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. **z. Artan Reka (DAP)**, CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Lulzim Rexhepi (DKRS);
- z. Artan Reka (DAP); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.203, datë:27.05.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.12763 e datës 26.05.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **“Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative”**, me numër të kontratës **KM653-25-3644-5-5-8**, dhe numër të AQP-së **UA/2016-24-3927-1-1-1** si në vijim:
 - 1.1. **z. Ahmet Ahmeti** (QKMF), CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **z. Edmond Kastrati** (DKA), CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Ahmet Ahmeti (QKMF);
- z. Edmond Kastrati (DKA); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIM TE QYLLIMOR
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Nr. i faq.
Br. str.

KONTRATË

KAMENICË/A

Numri i kontratës¹: KM653-25-3644-5-5-8/C690

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

Furnizim me paisje të teknologjisë informative me numër identifikues: KM653-25-3644-5-5-8 dhe numer te minitenderit nga AQP UA/2016-24-3927-111

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me paisje të teknologjisë informative** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me paisje të teknologjisë informative

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **30** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Objekti I KK Kamenice**

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **16,447.00 €**;
GjashtëmbëdhjetemijëekaterqindkaterdhjeteeshtateEuro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo marrëveshje e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Menaxher Ahmet Ahmedi
Mbikëqyrës Edmond Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPubliKA E KOSOVES	
REPubliKA KOS.	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY	
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. 13158
Br. 02	Opstina Kamenica
Nr. i faq. 1	Data: 28.05.2025
Br. str.	Datum: 2025
KAMENICËJA	



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.207, datë:28.05.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, z. **Latif Sylaj** (QKMF), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"Furnizimi me barna për pensionistët"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues z. **Latif Sylaj**, për Projektin: **"Furnizimi me barna për pensionistët"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Latif Sylaj (QKMF); dhe
- QSHQ - Arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAHANA

Nr. 02 Br. 13206
Nr. i faq. 2 Data: 29/05
Br. str. KAMENICE/A 2025



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.208, datë:29.05.2025

Kryetari i Komunës së Kamenicës, në bazë të nenit 13 dhe 58, shkronja a) dhe b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 8 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 7, 13 dhe 27 të Rregullores Sh.01.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, Vendimit Sh.02.Nr.4543 të datës 25.02.2025 për Formimin e Komisionit Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Mbështetjen Financiare Publike të Projekteve Kulturore dhe Rinore, Thirrja Publike Sh.13.Nr.2218 e datës 28.01.2025 për Mbështetje Financiare për Projekte Rinore dhe Thirrja Publike Sh.13.Nr.2222, datë 28.01.2025, për Mbështetje Financiare për Projekt-Propozimet e OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Kamenicës, Vendimit Sh.02.Nr.9776 të datës 24.04.2025, të nxjerrë nga Komisioni Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve për përcaktimin e aplikantëve të kualifikuar, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare për mbështetjen publike të projekteve të OJQ-ve kulturore dhe rinore, sipas Vendimit nr. Sh.02/9776, datë 24.04.2025, të nxjerrë nga Komisioni Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve për përcaktimin e aplikantëve të kualifikuar. Përfituesit janë përzgjedhur në bazë të aplikimeve në thirrjet publike: Sh.13/Nr.2218, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare të projekteve rinore; dhe Sh.13/Nr.2222, datë 28.01.2025, për mbështetje financiare të projekt-propozimeve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Kamenicës.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që, në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të realizojë procesin e pagesës së mjeteve financiare. Pagesa për përfituesit e projekteve kulturore, sipas listës së përfshirë në Vendimin nr. Sh.02/9776, datë 24.04.2025, të nxjerrë nga Komisioni Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve për përcaktimin e aplikantëve të kualifikuar, do të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i DKRS-së, ndërsa pagesa për përfituesit e projekteve rinore do të realizohet nga kodi buxhetor 16029 i Zyrës së Kryetarit.
3. Bashkëngjitur këtij vendimi janë kopjet e Vendimit Sh.02.Nr.4543, datë 25.02.2025, dhe Vendimit Sh.02.Nr.9776, datë 24.04.2025.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit; Zyrës për Informim, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe QSHQ - arkivit.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANIN
Nr. 02 Br. 13207
Nr. i faq. 1 Data: 29/05
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.206, datë 28.05.2025

Në mbështetje të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

VENDIM

Për autorizimin e përkohshëm për vozitjen e automjetit zyrtar

1. Autorizohet **z. Behar Hyseni** me vendbanim në **Kamenicë** me numër të letërnjoftimit **1241173905** të lëshuar nga MPB-ja, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës, që për nevoja të shërbimit të vozisë automjetin zyrtar të Komunës – **Skoda Octavia, ngjyrë e zezë metalike**, me targa **06Z-01-10** dhe numër identifikues **TMBAJ6NE4F0050742**.
2. I autorizuari është i lejuar të vozisë automjetin e lartcekur brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, vetëm për nevoja zyrtare të institucionit dhe me përgjegjësi të plotë.
3. Autorizimi vlen nga data 28.05.2025 deri më 15.06.2025, për periudhën e përcaktuar të shfrytëzimit të automjetit për realizimin e detyrave institucionale.
4. I autorizuari obligohet të respektojë të gjitha normat ligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me përdorimin e automjeteve zyrtare, përfshirë ruajtjen e automjetit dhe dokumentacionin përkatës.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Behar Hyseni (DKRS); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOS.
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Nr. 02 Br. 13282

Nr. i faq. 1 Data: 30/05
Br. str. Datum: 2025

KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.209, datë 30.05.2025

Në mbështetje të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

VENDIM

Për autorizimin e përkohshëm për vozitjen e automjetit zyrtar

1. Autorizohet **z. Edmond Kastrati** me vendbanim në fshatin **Karaçevë e Epërme** Komuna e **Kamenicës** me numër të letërnjoftimit **1241092026** të lëshuar nga MPB-ja, Zyrtar i Teknologjisë Informative në Drejtorin Komunal të Arsimit në Komunën e Kamenicës, që për nevoja të shërbimit të vozisë automjetin zyrtar të Komunës – **Toyota Yaris, ngjyrë e Bardhë**, me targa **06Z-26-10** dhe numër identifikues **VNKKAAC370A050090**.
2. I autorizuari është i lejuar të vozisë automjetin e lartcekur brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, vetëm për nevoja zyrtare të institucionit dhe me përgjegjësi të plotë.
3. Autorizimi vlen nga data 30.05.2025 deri më 15.06.2025, për periudhën e përcaktuar të shfrytëzimit të automjetit për realizimin e detyrave institucionale.
4. I autorizuari obligohet të respektojë të gjitha normat ligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me përdorimin e automjeteve zyrtare, përfshirë ruajtjen e automjetit dhe dokumentacionin përkatës.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Edmond Kastrati (DKA); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.210, datë: 30.05.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi i datës 27.05.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 94.00 €

1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 25-SHV01-001-19 të datës 27.05.2025, në shumë prej 94.00 € për shpenzimet e krijuara në REXHEP FONDAJ B.I, Fatura mbulon shpenzimet për dhuratat e siguruar nga Zyra e Kryetarit me rastin e vizitës zyrtare në Japoni.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 16029 Zyra e Kryetarit, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimit.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
5. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi i datës 27.05.2025, fatura Nr. 25-SHV01-001-19 të datës 27.05.2025, në shumë prej 94.00 €.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DFB-së; dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. 02
Br. 13358
Nr. i faq. 1
Data: 30/05
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.2011, datë 30.05.2025

Në mbështetje të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

VENDIM

Për autorizimin e përkohshëm për vozitjen e automjetit zyrtar

1. Autorizohet **z. Labinot Dërmaku** me vendbanim në fshatin **Shipashnicë** e **Epërme** Komuna e **Kamenicës** me numër të letërnjoftimit **1170826902** të lëshuar nga MPB-ja, Zyrtar për Buxhet dhe Financa në Komunën e Kamenicës, që për nevoja të shërbimit të vozisë automjetin zyrtar të Komunës – **Audi A3, ngjyrë e zezë metalike**, me targa **06Z-29-10** dhe numër identifikues **WAUZZZ8P86A158511**.
2. I autorizuari është i lejuar të vozisë automjetin e lartcekur brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, vetëm për nevoja zyrtare të institucionit dhe me përgjegjësi të plotë.
3. Autorizimi vlen nga data 30.05.2025 deri më 15.06.2025, për periudhën e përcaktuar të shfrytëzimit të automjetit për realizimin e detyrave institucionale.
4. I autorizuari obligohet të respektojë të gjitha normat ligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me përdorimin e automjeteve zyrtare, përfshirë ruajtjen e automjetit dhe dokumentacionin përkatës.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Labinot Dërmaku (DBF); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.212, datë 03.06.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

V E N D I M

1. Z. Vaxhid Rexhepaj, Shef i Kabinetit në Komunën e Kamenicës i delegohen përkohësisht përgjegjësitë e Drejtorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Behar Hyseni, për nënshkrimin e zotimeve të mjeteve për projektin: 'Organizimi i Festivaleve'.
2. Z. Vaxhid Rexhepaj, të cilit i janë deleguar përkohësisht përgjegjësitë sipas këtij vendimi, nuk ka të drejtë t'i nëndelegojë më tej këto kompetenca tek zyrtarë të tjerë apo persona të tretë. Këto kompetenca mbeten ekskluzivisht në kompetencën e tij gjatë periudhës së delegimit dhe ushtrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës.
3. Delegimi vlen vetëm për nënshkrimin e zotimeve të mjeteve për projektin: "Organizimi i Festivaleve".
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Vaxhid Rexhepaj;
- QSHQ-Arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHERBIMTE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAHANA

Sh. 02 Nr. 13726
Br. 1
Data: 04/06
Datum: 2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.213, datë 04.06.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016"), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

V E N D I M

1. Z. Vaxhid Rexhepaj, Shef i Kabinetit në Komunën e Kamenicës, i delegohen përkohësisht përgjegjësitë e Drejtoreshës së Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, znj. Burbuqe Leka, për nënshkrimin e zotimeve të mjeteve për projektin "Organizimi i Festivaleve".
2. Z. Vaxhid Rexhepaj, të cilit i janë deleguar përkohësisht përgjegjësitë sipas këtij vendimi, nuk ka të drejtë t'i nëndelegojë më tej këto kompetenca tek zyrtarë të tjerë apo persona të tretë. Këto kompetenca mbeten ekskluzivisht në kompetencën e tij gjatë periudhës së delegimit dhe ushtrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës.
3. Delegimi vlen vetëm për nënshkrimin e zotimeve të mjeteve për projektin: "Organizimi i Festivaleve".
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Vaxhid Rexhepaj;
- QSHQ-Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PER SHËRBIM TË QYLLIMIT CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh. U.	02	Nr. Br.	13808
Nr. i faq.	02	Data:	03/06/2025
Br. str.		Datum:	03/06/2025
KAMENICE/A			

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.214, datë:04.06.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimi Sh.02.Nr.42435, i datës 27.12.2023 për Formimin e Ekipës Menaxhuese të Kontratës, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimet Sh.02.Nr.13315, të datës 25.04.2024 dhe Vendimi Sh.02.Nr.33778, i datës 22.10.2024, Kërkesës Sh.02.Nr.12746, të datës 26.05.2025 e parashtruar nga z. Rushit Sopi përfaqësues i Lagjes, Kërkesës Sh.02.Nr.12822, të datës 26.05.2025 e parashtruar nga Ekipa Menaxhuese të Kontratës, Email-it Zyrtar nga “ENG – IDEA” Sh.p.k, e datës 28.05.2025 për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës, Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës, si dhe neni 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt

1. Miratohet kërkesa e Ekipës Menaxhuese të Kontratës, për aprovimin e ndryshimeve në projektin: **"LOT 1 Rregullimi i rrugëve në Malësinë e Kamenicës, Asfaltimi i rrugës Feriqevë - Gjyrishec"**, me Nr. të prokurimit: **KM:653-23-5244-5-1-1**.
2. Ndryshimi i pozicioneve brenda kontratës është inicuar nga Ekipa Menaxhuese e Kontratës për projektin e sipërcekur lidhur me ndryshimet në këtë projekt dhe e njëjta është aprovuar nga “ENG – IDEA” SH.P.K dhe Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit, Ekipa për Menaxhimin e Kontratës.
4. Kryetari i Komunës bazuar në kërkesën e lartcekur vendosi si në pikën (1) një të këtij vendimi.
5. Vendimit i bashkangjitet Kopjet nga Vendimi Sh.02.Nr.42435, i datës 27.12.2023 për Formimin e Ekipës Menaxhuese të Kontratës, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimet Sh.02.Nr.13315, të datës 25.04.2024 dhe Vendimi Sh.02.Nr.33778, i datës 22.10.2024,

Kërkesa Sh.02.Nr.12746, të datës 26.05.2025 e parashtruar nga z. Rushit Sopi përfaqësues i Lagjjes, Kërkesës Sh.02.Nr.12822, të datës 26.05.2025 e parashtruar nga Ekipa Menaxhuese e Kontratës, Email-it Zyrtar nga “ENG – IDEA” Sh.p.k, e datës 28.05.2025 për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës, Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, “ENG – IDEA” Sh.p.k (engidea16@gmail.com), Ekipës Menaxhuese sipas Vendimit Sh.02.Nr.42435, i datës 27.12.2023 për Formimin e Ekipës Menaxhuese të Kontratës dhe QSHQ – Arkivit.

**Kryetari i Komunës**
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës Sh.
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAHANA

02 Nr. 14017
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 09/06/2025
Br. str. KAMENICE

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.215, datë: 09.06.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), Vendimit Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-10226-5-1-1, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-10226-5-1-1

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.2 (një pikë dy) i Vendimit Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: **KM653-24-10226-5-1-1**.

1.1. Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.2 (një pikë dy) i Vendimit Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: **KM653-24-10226-5-1-1**, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të anëtarit të Ekipës Menaxhuese z. **Sylejman Kallaba** (DUPH), caktohet anëtar në Ekipën Menaxhuese z. **Imran Morina** (Konsulent, Drejtoria e Investimeve Kapitale).

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-10226-5-1-1.

3. Këtij vendimi i bashkëngjitet kopja e Vendimit bazë Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 për formimin e ekipës për menaxhimin e kontratës në tenderin: "LOT 1 – Ndërtimi i Çerdhës në Roganë - Kamenicë" me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-10226-5-1-1.

4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, z. Sylejman Kallaba (DUPH), z. Imran Morina (Konsulent, Drejtoria e Investimeve Kapitale), Anëtarëve të Ekipës Menaxhuese sipas Vendimit Sh.02.Nr.4024 të datës 20.02.2025 dhe Q.SH.Q - arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.217, datë: 09.06.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016); Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, për formimin e Ekipës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës me titull: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë", me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-1677-2-1-1; Vendimit Sh.02.Nr.38054, të datës 11.12.2024, për plotësim-ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024; Vendimit Sh.02.Nr.5560, të datës 12.03.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024; si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, për formimin e Ekipës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës me titull: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë", me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-1677-2-1-1

1. Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, për formimin e Ekipës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës me titull: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë", me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-1677-2-1-1, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Kryesuesit të Ekipës Menaxhuese, **z. Ali Berisha** (DSHPAIE), caktohet anëtar i Ekipës Menaxhuese, **z. Shaban Lenjani** (DSHPAIE), dhe riformulohet me këtë përbërje si në vijim:

1.1. Imran Morina (Konsulent, Drejtoria e Investimeve Kapitale), Kryesues i Ekipës Menaxhuese;

1.2. Shaban Lenjani (DSHPAIE), anëtar; dhe

1.3. Labinot Dërmaku (DBF), anëtar.

Mbikëqyrës i drejtëpërdrejtë i Ekipës për menaxhimin e Kontratës:

1.4. Ibrahim Kastrati (DSHPAIE).

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, për formimin e Ekipës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës me titull: “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë”, me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-1677-2-1-1.
3. Obligohet z. Ali Berisha (DSHPAIE) që, në cilësinë e Kryesuesit të Ekipës Menaxhuese në Kontratë sipas Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, të dorëzojë një raport të detajuar me shkrim lidhur me punët e kryera deri në periudhën e ndryshimit të vendimit në kontratën “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë” me numër të kontratës KM653-24-1677-2-1-1, dhe raportin t’ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, z. Imran Morina (Konsulent, Drejtoria e Investimeve Kapitale).
4. Këtij vendimi i bashkëngjitet kopja e Vendimit bazë Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024, për formimin e Ekipës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës me titull: “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë”, me numër identifikues të prokurimit: KM653-24-1677-2-1-1; Vendimi Sh.02.Nr.38054, të datës 11.12.2024, për plotësim-ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024; dhe Vendimi Sh.02.Nr.5560, të datës 12.03.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Sh.02.Nr.18960, të datës 10.06.2024.
5. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, z. Ali Berisha (DSHPAIE), z. Shaban Lenjani (DSHPAIE), Anëtarëve të ekipës për menaxhimin e kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.18960 të datës 10.06.2024 dhe Q.SH.Q - arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA E KOSOVES
QENDRA PER SHERBIM TE QYLLI
CENTAR ZA USLUGU GRAFANA

Sh. 02 Nr. 14193
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 10/06
str. Datumi: 2025
KAMENICEJA



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.219, datë:10.06.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Blerim Murina** (Drejtorja për Investime Kapitale), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"Ndërtimi i shtratit të lumit Astrit në Kopërnice"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Murina**, për Projektin: **"Ndërtimi i shtratit të lumit Astrit në Kopërnice"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (Drejtorja për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ - Arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.218, datë:10.06.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimi Sh.02.Nr.37090, i datës 29.11.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull: “Ndërtimi i pritorëve të autobusëve – Ritenderim 3”, me numër të kontratës KM653-24-10797-5-2-1, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Sh.02.Nr.38649, të datës 19.12.2024, Në bazë të kërkesës së parashtruar përmes emailit zyrtar nga 3 PEZ Studio, e datës 14.04.2025, Kërkesës së parashtruar përmes emailit zyrtar nga Menaxherja e Kontratës, znj. Vlonë Matoshi, e datës 03.06.2025, Emailit zyrtar të dërguar nga “Arhiko ING”, i datës 23.05.2025, lidhur me aprovimin e kërkesës për ndryshimin e pozicioneve brenda kontratës, Si dhe emailit zyrtar të dërguar nga Kryetari i Komunës, lidhur me aprovimin e kërkesës për ndryshimin e pozicioneve brenda kontratës, e datës 03.06.2025, si dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b), të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt

1. Miratohet kërkesa e 3 PEZ Studio dhe Menaxheres së Kontratës, për aprovimin e ndryshimeve në projektin: **“Ndërtimi i pritorëve të autobusëve – Ritenderim 3”**, me numër të kontratës **KM653-24-10797-5-2-1**.
2. Ndryshimi i pozicioneve brenda kontratës është inicuar nga 3 PEZ Studio dhe Menaxherja e Kontratës për projektin e sipërcekur lidhur me ndryshimet në këtë projekt dhe e njëjta është aprovuar nga “Arhiko ING” dhe Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit, Menaxherja e Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Kontratës.
4. Kryetari i Komunës bazuar në kërkesën e lartcekur vendosi si në pikën (1) një të këtij vendimi.
5. Vendimit i bashkangjitet Kopjet nga Vendimi Sh.02.Nr.37090, i datës 29.11.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të

kontratës me titull: “Ndërtimi i pritoreve të autobusëve – Ritenderim 3”, me numër të kontratës KM653-24-10797-5-2-1, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Sh.02.Nr.38649, të datës 19.12.2024, kërkesa së parashtruar përmes emailit zyrtar nga 3 PEZ Studio, e datës 14.04.2025, kërkesa e parashtruar përmes emailit zyrtar nga Menaxherja e Kontratës, znj. Vlonë Matoshi, e datës 03.06.2025, Emailit zyrtar të dërguar nga “Arhiko ING”, i datës 23.05.2025, lidhur me aprovimin e kërkesës për ndryshimin e pozicioneve brenda kontratës, Si dhe emailit zyrtar të dërguar nga Kryetari i Komunës, lidhur me aprovimin e kërkesës për ndryshimin e pozicioneve brenda kontratës, e datës 03.06.2025.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t’i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, “Arhiko ING” (arhiko.ing@gmail.com), Menaxheres së Kontratës znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të Menaxheres së Kontratës z. Besart Fejzullahu (DUPH) dhe QSHQ – Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHËRBIM TË QYT.
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 14259
U. Br. Kamenica Municipality

Nr. i faq. 1 Data: 10/06
Br. str. Datum: 2025
KAMENICE/A



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.220, datë:10.06.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.14191 e datës 10.06.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës me titull: **"Furnizim me lodra për parqe"**, me numër të kontratës **KM653-25-3311-1-2-1**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Amire Ismajli** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Znj. Vlonë Matoshi** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Amire Ismajli (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale);
- znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ-arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02
U.

Nr. 14325
Br.

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.221, datë: 10.06.2025

Nr. i faq. 1
Br. str.

Data: 11/06
Datum:

KAMENICE/A 2025

Në vështrim të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 70 të Statutit Sh.02.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, neneve 8, 10, 11, 12, 13, 17 dhe 20 të Rregullores Sh.02.Nr.31251, të datës 29.09.2023, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Vendimit Sh.02.Nr.6072, të datës 14.03.2025, për formimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve – në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, të datës 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up-eve në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, Rekomandimit Sh.02.Nr.14246, të datës 10.06.2025, të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve, në bazë të Vendimit Sh.02.Nr.6072, të datës 14.03.2025, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi Sh.02.Nr.14246, të datës 10.06.2025, i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve – në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, të datës 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up-eve në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 48029 i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, nga programi i subvencioneve.
3. Përgjegjësit për zbatimin e vendimit janë Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, kurse mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit e bën Kryetari i Komunës
4. Pjesë e këtij vendimi është lista me rekomandimin Sh.02.Nr.14246, të datës 10.06.2025, të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve – në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.4928, të datës 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up-eve në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, si dhe me vendimin Sh.02.Nr.6072, të datës 14.03.2025, për formimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve – në bazë të së njëjtës Thirrje Publike Sh.12.Nr.4928, të datës 03.03.2025, për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe start-up-eve në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe QSHQ - arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova Sh.
Republic of Kosova U.



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.222, datë:11.06.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 44 dhe 49 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e zyrtarit për monitorimin e funksionalitetit të sistemit të kamerave të sigurisë në objektet komunale

1. Caktohet z. Jeton Basha (Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative), në cilësinë e zyrtarit përgjegjës për monitorimin e funksionalitetit të sistemit të kamerave të sigurisë të vendosura në objektet komunale të Komunës së Kamenicës.
2. I caktuari është përgjegjës për kontrollin e rregullt të gjendjes funksionale të kamerave të sigurisë dhe për dorëzimin e një raporti në baza të rregullta pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme mbi funksionimin ose mosfunksionimin e tyre. Në rast të ndonjë defekti, ai obligohet të njoftojë menjëherë Drejtorinë.
3. Zyrtari përgjegjës duhet të sigurojë që monitorimi dhe ruajtja e të dhënave nga kamerat të bëhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet përkatëse nënligjore. Qasja në pamjet e kamerave është e kufizuar vetëm për personat e autorizuar me vendim.
4. Vendimi mbetet në fuqi deri në marrjen e një vendimi të ri që e ndryshon apo e shfuqizon atë.
5. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- z. Jeton Basha (DAP);
- Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme; dhe
- QSHQ-Arkivit.





REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 14458
U. Br. 12106

Nr. i fag. 2 Data: 2025
Br. str. KAMENICE/A Opstina Kamenica

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.196, datë:21.05.2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3.4, dhe paragrafëve 11 dhe 12 të Rregullores Sh.02.Nr.31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, Kërkesës Sh.02.Nr.11173 të datës 08.05.2025 të parashtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Kamenicë, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b), të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të rishqyrtimit të marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të Komunës së Kamenicës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për rishqyrtimin e marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të Komunës së Kamenicës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë

1. Formohet Komisioni për Rishqyrtimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit (shërbime për raste mortore).
2. Komisioni do të përbëhet nga këta anëtarë:
 - 2.1. Alban Hashani (Zyra e Kryetarit), Kryesues;
 - 2.2. Labinot Dërmaku (Drejtoria për Buxhet dhe Financa), Anëtar; dhe
 - 2.3. Riad Rahimaj (Zyra e Kryetarit), Anëtar.
3. Detyrë e Komisionit është të shqyrtojë përmbajtjen dhe zbatueshmërinë e marrëveshjes ekzistuese, të identifikojë nevojat për ndryshime eventuale, si dhe të japë rekomandime konkrete për përmirësimin apo rifreskimin e marrëveshjes në përputhje me interesin publik dhe ligjshmërinë.
4. Mandati i Komisionit zgjat deri në lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë.

5. Komisioni është i obliguar që të paraqesë draft-marrëveshjen përkatëse te Kryetari i Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.
7. Bashkëngjitur këtij vendimi është kërkesa Sh.02.Nr.11173 e datës 08.05.2025 të parashtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Kamenicë.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ-Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.223, datë:11.06.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, znj. Burbuqe Leka (DZHED),** Zyrtare Autorizuese për Projektin: **"Marrja në shfrytëzim e shtandeve për organizimin e panairit"**.
2. Zyrtarja Autorizuese nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtarja Autorizuese e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtarja Autorizuese **znj. Burbuqe Leka**, për Projektin: **"Marrja në shfrytëzim e shtandeve për organizimin e panairit"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Burbuqe Leka (DZHED); dhe
- QSHQ - Arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRSBIM TË QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 14468
U. Br. Kamenica

Nr. i faq. 1 Data: 12/06
Br. str. Datum: 2025

KAMENICE/A



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.224, datë:12.06.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.14253 e datës 10.06.2025, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Ndërtimi i impiantit për trajtimin e mbeturinave organike - Kamenicë (Qendra e kompostimit për menaxhimin qarkor të mbeturinave organike në Kamenicë)"**, me numër të kontratës **KM653-25-2251-5-1-1**, si në vijim:

1.1. z. Sylejman Kallaba (DUPH), CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 z. Besim Morina (DSHPAIE), CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Sylejman Kallaba (DUPH);
- z. Besim Morina (DSHPAIE); dhe
- QSHQ-arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLICA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Nr. 14253
Br. 30
Data: 19.06.2025
Br. str. 3025

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ KM653-25-2251-5-1-1/C694

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

HIDROING 2SH SH.P.K., Mulla Idrizi, Gjilan, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

NDËRTIMI I IMPIANTIT PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE ORGANIKE-KAMENICË (Qendra e kompostimit për menaxhimin qarkor të mbeturinave organike në Kamenicë) me numër identifikues: KM653-25-2251-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i qendres se kompostimit ne Komunen e Kamenices sipas projektit kryesor pjese perberese e dosjes se tenderit dhe pershkrimit te çmimeve**

No.	Lot
1	NDËRTIMI I IMPIANTIT PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE ORGANIKE-KAMENICË (Qendra e kompostimit për menaxhimin qarkor të mbeturinave organike në Kamenicë)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **706,450.35 €**; ShtatëqindëgjashtëmijëekaterqindëpesedhjeEuroe35cent.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.225, datë:12.06.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Sh.02.Nr.14241 e datës 10.06.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Menaxherit të Kontratës “Shërbimet e transportit dhe akomodimit – Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Kamenicë”

1. **CAKTOHET** Menaxheri i kontratës me titull: **“Shërbimet e transportit dhe akomodimit – Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Kamenicë”**, me numër të kontratës **KM653-25-3221-2-3-6**, si në vijim:
2. **z. Fadil Bunjaku** (DSHMS), **CAKTOHET** Menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
3. Obligohet menaxheri i kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Fadil Bunjaku (DSHMS); dhe
- QSHQ-arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

U. 02 Nr. 14984
Br. 14984

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.226, datë: 17.06.2025

Nr. i faq. 1 Data: 17/06
Br. str. 1 Datum: 2025
KAMENICA

Bazuar në nenin 13 dhe 58, shkronja a) dhe b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), Kërkesës Sh.02. Nr.14881 e datës 16.06.2025, të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës, si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 1,850.00 €

1. Lejohet pagesa për Organizimin dhe Realizimin e Manifestimit të përvjetorit të Çlirimit të Kamenicës, "Qershori i Lirisë", në shumë prej 1,850.00 € (Njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë euro).
2. Në kuadër të këtij manifestimi do të organizohen këto aktivitete:
 - 2.1 Koncert Folklorik;
 - 2.2 Koncert i Muzikës Klasike; dhe
 - 2.3 Aktivitete Sportive;
3. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të shpenzohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe DKRS përgatit raport duke arsyetuar mjetet e shfrytëzuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria Buxhetit dhe Financave në Kamenicë.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
7. Vendimit i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.nr.14881 e datës 16.06.2025, e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës dhe lista e Aktiviteteve të parapara.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, DBF-së, DKRS-së dhe QSHQ-arkiv.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.228, datë: 18.06.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kërkesën përmes emailit zyrtar të Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për Vlerësimin e kapaciteteve të NPL "Dardana", të dërguar me datë 16.06.2025, neni 9 paragrafi 4, lidhur me nenin 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Interpretimit të KRPP-së përkatësisht interpretimi Nr.1, i datës 22.11.2022, i publikuar në faqen zyrtare të E-Prokurimit, Vendimit Nr.07/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Themelimin Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh. A. në Komunën e Kamenicës, nenit 70, paragrafit 70.1, shkronjës b) të Statutit Sh.02.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të vlerësimit të kapaciteteve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" për zbatimin e kontratave të tipit "in-house", Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E KAPACITETEVE TË NPL "DARDANA" Sh.A

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e kapaciteteve teknike, financiare dhe organizative të Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A, me qëllim të shqyrtimit të mundësisë për zbatim të procedurës së kontratës të tipit "in-house", për menaxhimin e Vendgjuetisë së Përbashkët që shtrihet në territorin e Komunës së Kamenicës.
2. Komisioni do të përbëhet nga anëtarët në vijim:
 - 2.1. Qëndresa Kastrati (DZHED), Kryesuese;
 - 2.2. Labinot Dërmaku (DBF), Anëtar; dhe
 - 2.3. Sami Morina (DSHPAIE), Anëtar.
3. Komisioni do të ketë për detyrë të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse NPL "Dardana" Sh.A i plotëson këto kritere:
 - 3.1. Nëse është në 100% pronësi të Komunës së Kamenicës;
 - 3.2. Nëse Komuna ushtron kontroll funksional dhe efektiv mbi ndërmarrjen;

- 3.3. Nëse mbi 80% e të ardhurave të ndërmarrjes rrjedhin nga kontratat me Komunën;
- 3.4. Nëse ndërmarrja posedon kapacitetet teknike dhe njerëzore të nevojshme për menaxhimin e Vendgjuetisë së Përbashkët që shtrihet në territorin e Komunës së Kamenicës në përputhje me kërkesat ligjore dhe operacionale.
4. Komisioni obligohet që, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të hartojë një raport të detajuar me konstatime dhe rekomandime, dhe ta dorëzojë në Zyrën e Kryetarit brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
5. Mandati i Komisionit zgjat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi dhe pas aprovimit të raportit nga Kryetari i Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Komisioni i formuar si në pikën 1, ndërsa mbikëqyrja e zbatimit sigurohet nga Kryetari i Komunës.
7. Bashkëngjitur këtij vendimi është kërkesa përmes emailit zyrtar të Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për Vlerësimin e kapaciteteve të NPL “Dardana” Sh.A, të dërguar me datë 16.06.2025.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Ndërmarrjes Publike Lokale “Dardana” Sh.A;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kamenica Municipality
QENDRA PËR SHËRBYM TË QYLLI
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.229, datë:19.06.2025

Sh. 02 Nr. 15321
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 20/06/25
Br. str. Datum:

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Sh.02.Nr.14431 e datës 12.06.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Menaxherit të Kontratës “Shërbime të Konsulencës - Nutricionist”

1. CAKTOHET Menaxheri i kontratës me titull: **“Shërbime të Konsulencës - Nutricionist”**, me numër të kontratës **KM653-25-3617-2-3-6**, si në vijim:
2. **z. Ramadan Guda (DKA)**, CAKTOHET Menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
3. Obligohet menaxheri i kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Ramadan Guda (DKA); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj